

VENDIM
Nr. 50, datë 27.2.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DRIBEN” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET PRODHUES 2mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38 pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 145/2 prot., datë 26.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Driben’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Driben” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 3.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2mw dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 12.9.2024, vendosi të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Driben” sh.p.k., për arsye se nuk ishte kryer pagesa e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores për licencim. Pas kryerjes së pagesës, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 203, datë 27.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2024 dhe 2.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2057 prot., datë 8.10.2024 është njoftuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës me shoqërinë, ERE e ka njoftuar për vendimin nr. 187/2024 dhe dokumentacionin e munguar me shkresën nr. 1857/6 prot., datë 4.10.2024. Shoqëria ka dorëzuar dokumentacion plotësues me shkresën nr. 1857/7 prot., datë 11.10.2024, por kishte përsëri mangësi, ndaj Bordi i ERE-s me vendimin nr. 232, datë 30.10.2024, zgjati afatin e vendimarrjes me 15 ditë.

- Në vijim, me shkresat nr. 1857/10 prot. dhe nr. 1857/12 prot. në datat 12 dhe 13.11.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin, duke rezultuar në nevojën për një aplikim të ri për VNM-në. Për këtë arsye, me vendimin nr. 245, datë 14.11.2024, Bordi i ERE-s zgjati afatin e vendimarrjes deri më datë 1.12.2024.

- Pas njoftimeve dhe rikujtesës nga ERE me shkresat nr. 1857/14 prot. dhe nr. 1857/15 prot., shoqëria ka dorëzuar dokumentacion shtesë me shkresën nr. 1857/16 prot., datë 16.12.2024. Me vendimin nr. 289, datë 23.12.2024, Bordi i ERE-s vendosi pezullimin e vendimarrjes deri më datë 13.3.2025, në pritje të VNM-së paraprake të re, dokumentacionit mbi mbështetjen financiare dhe njoftimeve përkatëse për MIE-n mbi vlerën dhe ecurinë e investimit.

- Në vijim, shoqëria ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar me shkresën nr. 145 prot., datë 15.1.2025.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar kontratën me MIE-n nr. 10518 rep., nr. 4880 kol., më 28.12.2023;
- Ka marrë miratimin për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes përmes shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 6617/3 prot., datë 13.10.2022.
- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 8.1.2025, për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik me fuqi 2 mw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Kontrata e nënshkruar me MIE-n me nr. 10518 rep., nr. 4880 kol., datë 28.12.2023, parashikon një afat 49-vjeçar me të drejtë ripërsëritjeje.
- Bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, afati i vlefshmërisë së licencave për veprimtaritë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;
- VNM-ja është e vlefshme deri më datë 8.1.2027, por duke qenë se shoqëria parashikon të vendos në punë centralin brenda muajit dhjetor 2025, vlerësohet që t’i lihet saj kusht që të raportojë në ERE fillimin e punimeve brenda datës 30.9.2025 dhe të fillojë operimin e ushtrimit e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025.
- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 ditë, duhet të dorëzojë në ERE dokumentacionin për testimin e veprës.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Driben” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të raportojë në ERE fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit, deri brenda datës 30.9.2025.

3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025.

4. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit të pikave 2, 3 dhe 4.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Driben” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti